

Plani për Tiranën **2023 - 2027**



Tirana
NË DUART E TUA

**BELIND
KËLLIÇI**



Tirana
NË DUART E TUA



TABELA E PËRMBAJTJES

06 Transporti Publik

20 Biznesi në Zonat Urbane dhe Rurale

26 Mjedisi

40 Arsimi

50 Planifikimi Urban

58 TI Tirana

62 Shërbimi Social

78 Ujësjetësi

82 Trashëgimia Kulturore dhe Historike

90 Sporti





01



TRANSPORTI PUBLIK

AUTOBUSË PA PAGESË

Çfarë do të thotë?

Ne do të nxisim qytetarët që të përdorin masivisht transportin publik, duke hequr pagesat e biletave, duke e bërë të gjithë sistemin elektrik si dhe duke investuar në sigurinë, zgjerimin dhe cilësinë e shërbimit urban. Transporti pa pagesë jo vetëm ul koston e jetës, por edhe përbën një shërbim publik tjetër të nevojshëm që iu jepej taksapaguesëve në këmbim të tatimeve të mbledhura prej tyre.

Përse kjo nismë?

Lehtësohet trafiku rrugor pasi më shumë qytetarë do të zgjedhin të përdorin autobusët falas e të lënë makinat në shtëpi.

Pastrohet mjedisi, sepse ulja e numrit të makinave që qarkullojnë do e bëjë ajrin më të pastër e të shëndetshëm dhe do të ulë gjithashtu zhurmat në qytet.

Kursehet kohë, sepse rrugët e çliruara nga trafiku i shfryrë do të mundësojnë rritjen e shpejtësisë së lëvizjes nga një vend në tjetrin brenda qytetit, si dhe hiqen radhët e biletave dhe aboneve.

Ulet kostoja e jetës, sepse kostoja e biletave është peshë e rëndë për familjet e varfëra dhe mundësia për të lënë makinën në shtëpi ul koston e kripur të karburantit.

Më shumë parkime të lira në rrugë për të gjithë ata qytetarë që e kanë të pashmangshëm përdorimin e makinës, pasi rrugët do të kenë më pak qarkullim.

Si do të realizohet?

Për të shmangur mbipopullimin derisa të blihet numri i nevojshëm i autobusëve, kjo reformë do të zbatohet gradualisht duke filluar nga shtresat në nevojë.

Brenda dy vjetësh, Bashkia e Tiranës do të subvencionojë blerjen e autobusëve të rinj elektrikë nga operatorët privatë të autobusëve, në mënyrë që të rritet sasia, shpeshtia dhe cilësia e qarkullimit me autobusët qytetës.

Bashkia do të nxisë kalimin drejt autobusëve elektrikë që kanë kosto operacionale shumë herë më të ulët se ata me karburant. Secili autobus do të ketë pajisje GPS për të treguar vendndodhjen që do shfaqet në kohë reale në stacione dhe internet. Transporti do të bëhet shumë më i sigurt, sepse secili autobus do të ketë kamera të brendshme ndërsa stacionet e autobusëve do të jenë me kamera e ndriçim të bollshëm.

Do do të vendosen linjat e para të shpejta metrobus me korsi të dedikuar, të cilat do të kenë vetëm pak ndalesa për të patur tranzitim të shpejtë nga një anë e qytetit në tjetrën.

Për qytetarët që vijnë nga jashtë Tiranës do të aplikohet sistemi "Parko dhe Vazhdo".

Do të ndërtohen parkime shumëkatëshe dhe të sigurta në pikat kyçe të hyrjes në Tiranë, ku të lënë makinat e tyre dhe mandej të udhëtojnë drejt qendrës së qytetit me autobusë falas.

TRANSPORTI PUBLIK MODERN DHE **FALAS** NË DUART E TUA

**UL KOSTON
E JETESËS**

3

GPS

**AUTOBUSË
MODERNË FALAS**

1



ZVOGËLON NDOTJEN E
AJRIT DHE ZHURMAVE

4

KURSEN KOHËN

5

LIRON
PARKIMET

6

P

FRESK 5 MIN

WI-FI

2

SHFRYN TRAFIKUN

Sa kushton nisma?

Kosto aktuale e transportit publik në Tiranë është rreth 16.5 milionë euro në vit.

Buxheti aktual i Bashkisë Tiranë është përafërsisht 240 milion euro. Për të rritur cilësinë dhe arritur numrin e duhur të autobusëve, bashkia do të dedikojë afërsisht 5 milionë euro në vit për të subvencionuar operatorët privatë që të blejnë autobusë të rinj elektrikë. Pra, në total transporti pa pagesë së bashku me modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit do t'i kushtojë bashkisë rreth 21.5 milionë euro në vit nga taksat e mbledhura prej qytetarëve.

Masa të tjera për të lehtësuar trafikun:

- **Rivendosja e qarkullimit të trafikut nën Sheshin Skënderbej.**
Kjo është një ndërhyrje thelbësore për të risjell normalitetin e trafikut në drejtimin veri-jug. Në të njëjtën kohë do të reduktojë shumë herë ndotjen ekstreme në qendër të Tiranës
- **Rikonceptimi i sistemit të qarkullimit në të gjithë Tiranën.**
Do zgjidhim trafikun në pikat kyçe ku ai bllokohet, duke përdorur rrugët dytësore si shfryrëse, sipas nje koncepti modern të menaxhimit të trafikut, të ndryshëm nga ky që është sot në funksion. Do të zgjerojmë hapësirën që mbulon sot Qendra e Kontrollit të Trafikut të Tiranës dhe do ta integrojmë atë me Qendren Kombëtare të Kontrollit të Trafikut dhe platformën Tirana Inteligjente.
- **Hapja/zgjerimi i rrugëve/rrugicave të reja brenda zonave të banueshme,** duke gjetur skema kompensimi për terrenet që do të preken
- **Hartimi i standardeve të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve urbane dhe rritjen e sigurisë rrugore.**

Unaza e Re dhe akse të tjera

- Do të ndërtojmë me përparësi **Unazën e Re të kryeqytetit, Kashar-Arbanë-TEG,** me një gjatësi rreth 20 km. Kjo do të eliminonte edhe hyrjen e trafikut të Veriut e Jugut (pra trafikut tranzit) që nuk ka destinacion fundor Tiranën, duke sjell ulje të ndjeshme të trafikut dhe ndotjes në kryeqytet

■ Ndërtimi i linjave /BRT (Bus Rapid Transit) :

- Në Unazën e Tiranës;
 - Në aksin Kombinat-Kinostudio;
 - Ish Stacioni i Trenit – Paskuqan;
 - Ish Stacioni Trenit - Terminali Multimodal i Autobusëve – Zona Industriale deri në kufirin me Vorën. Kjo linjë i shërben rreth 65.000 punonjësve ditore
- Korsi e dedikuar për linjat kryesore të transportit publik brenda Tiranës
 - Reduktim me 50% i kohës së pritjes në çdo stacion të transportit publik.
 - Rritje dyfish e frekuencës së mjeteve.
 - Vendosja e semaforëve priorizues dhe e sistemit elektronik të biletave
 - GPS për mjetet dhe shfaqjen e tyre në stacione
 - Kamera sigurie në çdo autobus dhe stacion.
 - Aplikacion për të loguar qytetarët për linjat dhe stacionët, si dhe për të marrë informacion mbi orarët dhe trafikun.

■ Parkimi

- Brenda dy viteve të para do të zgjidhim problemin e parkimit në Tiranë. Të gjitha të ardhurat që vijnë nga parkimi dhe gjobat (rreth 7 milionë euro në vit) do të investohen në zgjidhje të reja inovatore për parkimin në Tiranë, veçanërisht për hapësirat mes pallateve
- Rezidentëve do t'u garantohet parkim i sigurt në lagjet e tyre. 80 % e të gjitha vendeve të parkimit do të rezervohen për rezidentët (nga më pak se 50% që është sot)
- Ndërtimi i disa pikave Parko & Pedalo dhe Parko & Vazhdo
- Parkimet e reja nëntokësore

■ PROJEKTI I NDËRTIMIT TË PARKIMEVE NËNTOKËSORE PRIVATE.

Ndërtimi i papërgjegjshëm dhe i keq-planifikuar ka bërë që numri i parkimeve në qytet të jetë shumë i kufizuar dhe qytetarët të detyrohen të harxhojnë kohë e karburant në kërkim të një vend-parkimi të lirë duke rritur nivelin e ndotjes. Në të tilla rrethana

ndërtimesh të ngjeshura, zgjidhja e vetme është ndërtimi i dhjetëra parkimeve nëntokësore në bashkëpunim me sektorin privat.

Qeverisja e re e bashkisë do të rishqyrtojë Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit dhe Planet e Detajuara Vendore, dhe në bashkëpunim me sektorin privatë inisiativa private, të identifikojë në mes të zonave të mbipopulluara, terrene publike e private që kanë potenciale për zhvillimin e parkimeve nëntokësore me shumë kate (3-5 nëntokë).

Ndërsa nëntoka do të përdoret për shërbimin e parkimit të automjeteve, sipërfaqja e terrenit do të shfrytëzohet për aktivitete të tjera që kërkojnë hapsira të hapura, të gjelbërura, rekreative dhe sportive; ose për ndërtesa publike të infrastrukturave sociale (arsimore, shëndetsore, kulturore, administrative; 1-3 kate).

Ky projekt ka përfitime të shumëfishta:

- Përbush nevojën e madhe për parkime
- Çliron rrugën nga mjetet e parkuara dhe lehtëson trafikun.
- Siguron territore të hapura, të gjelbërta, rekreative dhe sportive
- Rrit nivelin e sigurisë për automjetet dhe qytetarët
- Sjell përfitime mjedisore
- Ofron mundësi të reja veprimtarie fitimprurëse për pronarët privatë dhe ndërtuesit
- Siguron troje për të ndërtuar institucione të nevojshme publike
- Siguron mundësi të reja për sipërmarrjen private
- Garanton mbrojtje më të mirë nga elementet atmosferikë për automjetet
- Rrit hijeshinë dhe vlerën e pronave të zonës përreth



KORSI BIÇIKLETASH QË NUK DËMTOJNË BIZNESET E KONSUMATORËVE DHE QË NUK RREZIKOJNË ÇIKLISTËT

Ne do të inkurajojmë përdorimin më masiv të biçikletave në Tiranë si një alternativë më e lirë, e pastër dhe e shëndetshme e transportit publik, prandajmë do të investojmë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të korsive të dedikuara të biçikletave. Mirëpo korsitë aktuale duhet të përmirësohen, shtohen e të bëhen më të sigurta si dhe do të transferohen tjetërkund nëse aktualisht dëmtojnë bizneset e vogla dhe konsumatorët.

Kryebashkiaku Veliaj punon për interesat e bizneseve të mëdha që ka ortakë në kurriz të bizneseve të vogla sepse korsitë aktuale të dedikuara të biçikletave dëmtojnë biznesmenët e vegjël dhe konsumatorët e rrugëve tradicionale tregtare dhe favorizojnë qendrat e mëdha komerciale që kanë parkime. Korsitë e biçikletave sikurse çdo gjë tjetër në Tiranë, janë ndërtuar në mënyrë të ngutshme e rrëmujshme, pa planifikim cilësor e pa u kujdesur as për bizneset dhe konsumatorët që mund të dëmtoheshin nga ndërtimi i tyre e as për sigurinë e çiklistëve.

Transferimi i korsive të biçikletave për të mos dëmtuar bizneset

Bizneset e vogla janë shumë të rëndësishme për shoqërinë, sepse mbajnë shumicën e familjeve të Tiranës me të ardhura.

Po ashtu bizneset e vogla garantojnë konkurrencën e lirë dhe çmime të ulëta sepse pengojnë abuzimet e bizneseve të mëdha që kanë mbështetje politike.

Korsitë aktuale të biçikletave po çojnë në falimentim bizneset e vogla të rrugëve tregtare sepse konsumatorët e tyre tradicionalë e kanë të pamundur që të parkojnë për të shkuar tek ato.

Zëvendësimi i parkimeve të mëparshme me korsi biçikletash në këto rrugë, po detyron konsumatorët potencialë që të udhëtojnë larg, drejt qendra të mëdha komerciale, sepse vetëm atje ka parkime.

Heqja e parkimeve të makinave buzë rrugëve tregtare ka bërë që shumë qytetarë të harxhojnë më shumë kohë e karburant për të bërë blerje diku larg tek tregtarët e mëdhenj.

Prandaj korsitë e bicikletave do të transferohen atje ku janë më të mbrojtura larg makinave, në mënyrë që mos të dëmtojnë bizneset e vogla dhe konsumatorët e tyre.

Transferimi i korsive në vende më të sigurta dhe rikthimi i parkimeve në këto rrugë me biznese do të rimëkëmbë bizneset e vogla dhe do të kursejë kohë e para për qytetarët.

Rritja e sigurisë së korsive të dedikuara të biçikletave

Do të bëhet një plan reformues për infrastrukturën e korsive të dedikuara të biçikletave duke patur si objektiv kryesor rritjen e sigurisë së tyre.

Transferimi i korsive ekzistuese të biçikletave, larg rrugëve tradicionale tregtare i shërben jo vetëm biznesmenëve të vegjël dhe konsumatorëve tradicionalë të tyre, por edhe sigurisë së çiklistëve.

Për arsye sigurie, rekomandohet që korsitë e biçikletave të vendosen pranë shtigjeve të këmbësorëve dhe jo pranë korsive të makinave sikurse është bërë në rrugët tregtare të Tiranës prandaj do të transferohen prej aty, drejt rrugëve të brendshme të pallateve apo shtëpive.

Në zonat ku korsitë nuk dëmtojnë bizneset e vogla dhe duhet medoemos të vendosen anës rrugëve, do të vendosen ndarëse fizike të forta mes makinave dhe biçikletave për të mbrojtur çiklistët.

Do të bëhet instalim i ndriçimit të përshtatshëm përgjatë korsive të biçikletave për të rritur dukshmërinë dhe sigurinë, veçanërisht në kryqëzime dhe zona periferike me pak ndriçim.

Do të instalohet një sinjalistikë e përshtatshme për ciklistët, siç janë pasqyrat e sigurisë, treguesit e kthesave dhe treguesit e shpejtësisë.

Do të promovohet përdorimi i pajisjeve të sigurisë si kasketa në kokë, drita e sinjale reflektuese në biçikletë për të ndihmuar në rritjen e sigurisë së çiklistëve në rrugë.

Do të zhvillohet një aplikacion për smartphone në kuadër të TI Tiranës inteligjente që të ndihmojë çiklistët e Tiranës që të ndjekin trafikun në kohë reale, të zgjedhin itinerarin më të përshtatshëm dhe t'i paralajmërojë ata për rreziqe të mundshme në trafik.

Do të vendosen kamera dhe sensorë për monitorimin e sjelljes së shoferëve dhe ciklistëve në rrugë.



NËNKALIMI NË SHESHIN SKËNDERBEJ

Qendra e Tiranës është bërë prej vitesh gangrena kryesore e trafikut të tejnqarkuar të Tiranës dhe ndërtimi i hovshëm i kullave të reja polifunksionale përreth qendrës pritet që ta përkeqësojë akoma më shumë gjendjen. Me bllokimin e sheshit Skënderbej dhe shndërrimi i tij në shesh vetëm për këmbësorët, e gjitha ngarkesa e trafikut është përqendruar tek unaza e vogël e cila nuk ka mundësi të përballojë vëllimin aktual të qarkullimit, e jo më atë që pritet të vijë. Zgjidhja për këtë situatë është ndërtimi i një nënkalimi me katër korsi poshtë sheshit Skënderbej për të shfryrë ngarkesën në unazën e vogël.

Ky nënkalim do të lidhë Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” me atë “Zogu i Parë” duke mundësuar lëvizjen e lirshme të makinave në drejtimin Veri-Jug e anasjelltas. Shumica e makinave që kalon aktualisht në unazën e vogël do të mund të shfrytëzonte këtë nënkalim duke evituar vërdallisjen nëpër semaforë. Projekti përlogaritet të kushtojë rreth 4.5 milionë euro dhe do të jetë 400 metra i gjatë nga të cilat 200 metra do të jenë tunel që nuk do e cënojë parkimin nëntokësor ekzistues.



Projekti përlllogaritet të kushtojë rreth 4.5 milionë euro dhe do të jetë 400 metra i gjatë nga të cilat 200 metra do të jenë tunel që nuk do e çënojë parkimin nëntokësor ekzistues.

Përfitimet që vijnë nga ky projekt të shumtë sepse shfryn ndjeshëm trafikun e Tiranës, shkurton kohën e udhëtimit për automjetet, lufton ndotjen e ajrit dhe të zhurmave, rrit sigurinë e shoferëve dhe pasagjerëve si dhe rrit aktivitetin ekonomik në një zonë që njerëzit e kanë shmangur për shkak të trafikut





02



MBESHTETJE PER BIZNESIN

Programi Ynë për Biznesin e Vogël dhe të Mesëm

Bizneset e vogla e të mesme janë shtylla e ekonomisë së Tiranës, janë punëdhënësit më të medhenj dhe sigurojnë të ardhura për shumicën e familjeve të Tiranës.

Konkurrenca e shëndetshme që ato garantojnë, i mban çmimet të përballueshme për të gjithë banorët dhe pengon abuzimet e bizneseve të mëdha që kanë mbështetje politike. Shtimi i taksave gjatë viteve të fundit, përbën një barrë të rëndë për këta sipërmarrës të ndershëm. Sot ata paguajnë taksë të kripura dhe nuk marrin mbështetje nga bashkia.

Shërbimet apo investime infrastrukturore të bashkisë gjithashtu lënë shumë për të dëshiruar. Prandaj është propozuar një plan për të mbështetur bizneset duke ulur taksat për bizneset e vogla dhe të mesme në zonën urbane dhe për të subvencionuar bizneset e fermerëve.

BIZNESI NË ZONAT URBANE

TAKSAT DHE TARIFAT QË PAGUAJNË BIZNESET SOT DHE SA DO TË PAGUAJNË NË TË ARDHMEN

1. Llojet e taksave

- Taksa e Përkohshme për Infrastrukturën arsimore bëhet ZERO (hiqet si takse)
- Taksa e Tokës Bujqësore bëhet ZERO (pjesa që i takon Bashkisë)
- Taksa e Fjetjes në Hotel REDUKTOHET me 30%
- Taksa e Tabelës Informuese REDUKTOHET me 30%
- Taksa e Trullit REDUKTOHET me 30%
- Taksa mbi ndërtesën reduktohet me 30%
- ✓ Nga këto reduktime taksash biznesi i vogël përfiton 4.000-9.000 lekë
- ✓ Biznesi i mesëm përfiton nga 15.000-27.000 lekë
- ✓ Biznesi VIP përfiton nga 22.000-32.000 lekë.
- ✓ Ndërmarrjet bujqësore përfitojnë 1.800-5.600 lekë për hektarë në varësi të tokës.

- ✓ Bizneset në sektorin e Hotelerisë do të përfitojnë nga 40-100 lekë për çdo fjetje.
- ✓ Bizneset që kanë tabela të thjeshta do të përfitojnë një ulje deri në 13.500 lekë për m² në vit;
- ✓ Bizneset që kanë tabela elektronike do të përfitojnë një ulje deri në 27.000 lekë për m² në vit.
- ✓ Bizneset që kanë truall në të ardhmen do të paguajnë 30% më pak apo 0,39 lekë/m² në vit.
- ✓ Bizneset në të ardhmen për taksën mbi ndërtesën do të paguajnë 30% më pak apo e thënë ndryshe perlllogaritja do të bëhet: $\text{cmimi} \times 0.98 \times 1.4\%$.



2. Llojet e tarifave

- Tarifa e Pastrimit dhe Gjelbërimit REDUKTOHET me 50%
- Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike REDUKTOHET me 50%
- ✓ Nga këto reduktime tarifash biznesi i vogël përfiton 1.750-6.000 lekë në vit
- ✓ Biznesi i mesëm përfiton nga 10.000-25.000 lekë
- ✓ Biznesi VIP përfiton nga 25.000-225.000 lekë.
- ✓ Bizneset e shërbimeve që përdorin hapësirat publike do të përfitojnë në varësi të zonave 200 -750 lekë për m², për çdo muaj.

3. Përfitimet mujore të bizneseve

- ✓ Në total një biznes i vogël shërbimesh mund të përfitojë gjithsej 35.000-42000 lekë çdo vit, apo thënë ndryshe nga 2.900 deri ne 3.500 lekë çdo muaj si pasojë e reduktimeve të taksave dhe tatimeve locale
- ✓ Në total një biznes i mesëm shërbimesh mund të përfitojë gjithsej 53.500-79.000 lekë çdo vit apo thënë ndryshe nga 4.500 deri ne 6.600 lekë çdo muaj si pasojë e reduktimeve të taksave dhe tatimeve locale
- ✓ Në total një biznesi VIP shërbimesh mund të përfitojë në kompleks nga 60.500-284.000 lekë çdo vit apo thënë ndryshe nga 5.000 deri ne 23.600 lekë çdo muaj si pasojë e reduktimeve të taksave dhe tatimeve locale
- ✓ Në total një biznes i vogël që është Bar-Kafe apo Restorant qe shfrytëzon edhe hapësirë publike rreth 10 m2, do të përfitojë edhe një ulje nga 2.000-7.500 lekë në muaj, plus (24000- 90000 lekë në vit). Pra do të përfitojë në kompleks nga 59.000-132.000 lekë çdo vit, apo thënë ndryshe nga 50.000 deri ne 110.000 lekë të vjetra çdo muaj si pasojë e reduktimeve të taksave dhe tarifave lokale.

BIZNESI NË ZONAT RURALE

- 7 milionë euro të buxhetit tone vendor, do te shkoje çdo vit ne financimin e skemave mbeshtetese ne bujqesi dhe blegtori
- 3 milione euro per te mbeshtetur huamarrjen e fermerëve
- 2 milionë euro do të shkojnë si mbeshtetje per Produktet “Made in Tirana”, per prodhuesit dhe tregtarët e tyre, si dhe
- 1 milione euro si mbeshtetje per certifikimin organik dhe bio te produkteve bujqesore
- 0% taksa per te gjithë fermeret e Tiranës qe do te shesin ne Tregjet e gjelberta
- 100 kilometra rrugë rurale
- 5 milion euro për meremetimin e digave dhe pastrimin e rehabilitimin e liqeneve dhe sistemeve të kullimit e vaditjes.

Paketa mbështetëse për çdo fermer:

10 mije euro mbështetje ne baze materiale per cdo fermer për të forcuar biznesin e tij të ri dhe për të shtuar prodhimin e ushqimeve të lira, cilësore e të freskëta për qytetarët e Tiranës.

Kjo do te thotë:

- 6 deri ne 8 lope te rraces
- 50 deri 60 dele te rraces
- 1000 pula pjellëse apo zogj per mish
- 100 mije rasate trofte per rezervuar
- Vlerën e inputeve dhe fidanëve per te mbjelle, per sipërfaqe me te mëdha se 0,1 ha, me kufi te sipërm deri 2500 euro ne vit
- Subvencionim 100% per karburant per punimin e sipërfaqeve deri ne 1 ha, por jo me te vogla se 0,1 ha

Mbështetja per produktet “Made in Tirana”

- Subvencionim deri ne 5 0% te kosos se produktit per te gjitha prodhimet blegtorale bulmetore “Made In Tirana”, qe kane destinacion tregun e Tiranës
- Subvencionim deri ne 50% te kosos se produktit per te gjitha prodhimet hortikulturor, frutikulture, akuakulture “Made In Tirana”, qe kane destinacion tregun e Tiranës
- Zero taksa bashkiake per te gjithë fermerët qe do te shesin prodhimet “Made in Tirana” ne tregjet e gjelberta te Bashkise Tirane

Mbështetje tjetër direkte për Fermerët

- Per fermerët qe do te certifikojnë organikiisht produktet e tyre, mbulimi i shpenzimeve deri ne 50%
- Per fermerët qe do te marrin hua ne banke per investime ne agrikulture apo dhe agroturizem (ne infrastrukture), per kredi deri ne 30 mije euro, kredi me interes zero sepse bashkia do te mbuloje interesin e kredisë prene bankës përkatëse





03



MJEDISI

Gjelbërimi

Ndërtimi i 500 Oazeve të Gjelbëra të vogla dhe të mesme në qytet, mes pallateve, sipas metodës Miyawaki.

Për të riparuar sadopak dëmin e shkretëtirës së çimentos dhe për ta bërë qytetin më të jetueshme do ndërtohen 500 oaze me gjelbërim në hapësirat publike të Tiranës, nga një në çdo lagje.

Në këtë mënyrë të gjithë kudo në Tiranë do të kenë afër shtëpisë së tyre një xhep të gjelbër, me përmasa sipas mundësive, ku të mund të shlodhet, ku fëmijët të mblidhen e të lozin, ku të moshuarit të takohen me miq e nënat të shëtisin fëmijët në karrocë.

Secili kopsht do të kushtojë rreth 10 mijë euro për t'u krijuar e sistemuar duke shpenzuar në 4 vjet 5 milionë euro. Do të përdoret një metodë japoneze e kopshtarisë e përshtatur enkas për zona urbane të mbingarkuara, që konsiston në mbjelljen në disa shtresa, të shumë bimëve të larmishme brenda sipërfaqe të vogël tokësor.

Sipas kësaj metode mjaftojnë të paktën 200 m² për ndërtimin e një mini-pylli me bimë të zonës që rriten shpejtë dhe kanë pak nevojë për mirëmbajtje. Këto të gjelbërt në zonat e ngjeshura urbane do të pastrojnë ajrin, zbukurojnë mjedisin, rrisin biodiversitetin, pakësojnë përmbytjet, stabilizojnë temperaturat, përmirësojnë gjendjen psikologjike dhe pasurojnë jetën në komunitet.



Projekte të tjera

Shumëfishim i sipërfaqes së gjelbër brenda dhe përreth Tiranës.

- Krijimi i fidanishtes së Tiranës.
- Krijimi dhe dendësimi i Korridoreve të Gjelbra brenda qytetit që do të shërbejnë për ecje, vrap apo ngjarje sportive për qytetarët.
- Pyllëzim dhe infrastrukturë funksionale për 6 Parqe Natyrore në kursorën rrethuese të Tiranës.



Parku i Kollogjeshit, sipërfaqe rreth 2000 ha



Parku i Liqenit të Kusit, Kashar, rreth 100 ha



Parku i Liqenit të Rovës, Baldushk, rreth 200 ha



Parku i Liqenit të Fjollës, Pezë, rreth 100 ha



Parku i Liqenit të Prushit, Lalm dhe Allgjatë, rreth 30 ha



Parku 3-Liqenor i Linzës, Tufinës dhe Priskës, rreth 20 ha.

Ajri:

- Plan i Integruar për Cilësinë e Ajrit dhe Monitorimin e Zhurmave, brenda 30 ditëve.
- Instalim i rjetit të 25 stacioneve fikse për ajrin dhe 60 stacioneve për zhurmat. Monitorim 24 orë, dhe rezultate transparente në kohë reale.
- Ulja e nivelit të ndotjes nga karburanti (Park & Vazhdo – parkim në pikat hyrëse të qytetit, transport falas, më pak makina në qarkullim).
- Penalizim i kompanive të ndërtimit që shkelin rregullat teknike për eliminimin e pluhurit dhe baltës së rrugë.

Pastrimi i Lumit Lana:

Brenda mandatit të parë, nga një vend-shkarkim i gjithë ujërave të zeza dhe një turp që kuntërbon në qendër të Tiranësi, Lumi Lana do të kthehet në një hapësirë pushimi dhe rekreacioni. Ujërat e zeza nuk do të derdhen më në Lanë, në liqenin artificial apo atë të Farkës.

Në segmentin lumor, nga “Materniteti i Ri” e deri te “Pallati me Shigjeta”, do të shtrohen tuba në skarpatën e lumit, që do të mundësojnë kalimin e ujërave të zeza nga daljet e deritanishme me dy kolektorë me kapacitet të madh, të cilët do të lidhen me impiantin e ujërave të zeza në Kashar.

Ky projekt përllongaritet të kushtojë diku tek 8.5 milionë euro por do i japë fund njëherë e mirë aktualitetit unik në Evropë, ku ujërat e zeza derdhen në një kanal në qendër të qytetit.

Zgjidhjet të tjera mjedisore të propozuara

Referendumet Vendore për çështje të Komunitetit: fuqizojmë qytetarin

Do të organizojmë referendume vendore për tema të lidhura me zhvillimin urban dhe vendimmarrjen mjedisore. Kjo do të lejojë komunitetet të kenë fjalën e fundit për vendimmarrjen.



Manaxhimi i mbetjeve urbane: sipas standardeve të BE

Rikonceptimi i gjithë sistemit të manaxhimit të mbetjeve urbane të bashkisë, nga koshat deri në asgjësimin përfundimtar duke mbajtur parasysh hearkinë alternative të trajtimit të mbetjeve;

- Diferencim pikash grumbullimi Biznese / Familjar
- Diferencim mbetjesh në burim (Organike / Të thata)
- OIncineratori nuk duhet të ndërtohet por në vend të tij të rikoceptohet një impjant i cili riciklon, rikualifikon mbetjet dhe një impjant tjetër i cili mbetjet e refuzuara i përpunon duke i kthyer në Lëndë Djegëse Alternative të cilat më pas tregtohen tek Industria vendase që ka furra të cilat operojnë në temp. + 1400 gradë

Hapësirat e gjelbëra:

- Krijimi i koridoreve të gjelbëra brenda qytetit ose që përshkojnë qytetin (që të përdoren nga qytetarët për ecje ose vrap
- Dendësimi me mbjellje të reja i sipërfaqeve/koridoreve ekzistues
- Konceptimi edhe fillimi i krijimit të parkut/pyllit të lagjeve/fshatrave në zonat rurale të bashkisë
- Lirimi hapësirave publike subjekt i shtesave të bar-kafeve dhe rikonceptimi i tyre si xhepa të gjelbër urban në kuadër të oazeve



Cilësia e ajrit dhe ndotja akustike: Monitorim dhe masa parandaluese dhe penalizuese

- Brenda vitit miratohet plani i integruar për Cilësinë e Ajrit Urban dhe paralelisht të instalohet rrjeti me të paktën 25 stacione fikse të cilat monitorojnë ajrin 24/7; (Një qëndër monitorimi ajri e mirë kushton 60 mijë euro. Ku pritet që të paktën një pjesë të bëhet me fonde nga donatorët e huaj ndërsa Bashkia pritet të japi një fond deri në 20 milionë euro për 4 vite.)
- Brenda vitit të përditësohet Plani i Menaxhimit të Zhurmave dhe paralelisht të instalohet rrjeti me të paktën 60 stacione fikse të cilat monitorojnë ajrin 24/7
 - Vendosija e rrjetit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në zonat urbane.
 - Vendosija e stacioneve të monitorimit të niveleve të zhurmave, përfshi përditësimin e hartës së zhurmave në zonat urbane

Policia Bashkiake të ketë degën e Policisë Mjedisore e cila adreson kosntatimet nga komunitetit

- Task/Forcë për monitorimin e shkarkimeve nga operatorët prodhues/përpunues/ndërtues në Bashkinë Tiranë
- Task/Forcë për monitorimin e shkarkimeve akustike nga operatorët prodhues/përpunues/ndërtues në Bashkinë Tiranë
 - Ngritja e strukturës për informimin e përditësuar të qytetarëve dhe hartimin e zbatimin e masave për përmirësimin eliminimin e zhurmave dhe cilësisë së mjedisit

- Lirimi hapësirave publike të zëna nga subjekte-bar kafe dhe përshatja me bimësi e cila ndikon në abosrbimin e ndotjes (potencial për ti shtuar qytetit të paktën 17 ha hapësira të gjelbra brenda zonës me dëndësi të lartë urbane)

Këmbësorët në qytet: Trotuaret vetëm për këmbësorët

- Sistemimi edhe rikonceptim i trotuareve edhe hapsirave publike me përparësi, karrocet e fëmijëve, personave me aftësi ndryshe, të moshuarve dhe këmbësorëve

Pastrimi i qytetit nga operatorët e pastrimit.

- Pastrimi nëpërmejt larjes së rrugëve kryesore në kryeqytet do të bëhet periodike dhe sipas standardeve më të mira evropiane

EFIÇENCA ENERGETIKE E NDËRTESAVE

- Çdo familje që banon në pallat ka mundësi që të reduktoj me 20% kërkesën për energji nga OSHEE nëse instalon sisteme fotovoltaike në tarracë
- Aktualisht ligji kombëtar dhe ai lokal nuk e lejon aplikimin e një feed-in tarrif apo shkembimit 1kwh me 1kwh ndërmjet konsumatorit familjar dhe ofruesit të energjisë
- Skema për rrijten e efiçensës së godinave duhet projektuar sidomos për pallatet e kohës së komunizmit
- Shërbimi publik i ndriçimit të rrugëve dhe shkallëve mund të ketë kosto zero në afatshkurtër nëse Bashkia Tiranë investon në ndërtimin e një impjanti fotovoltaike të dedikuar.

PYJET DHE LIQENET

Bashkia do të vendosë për herë të parë për Programin e “Pyjeve të shëndetshme dhe Liqeneve të pastra”, një shumë prej 28 milionë euro nga buxheti, nga te cilat,



A.12 Milionë Euro për Pyllëzimin dhe Ripyllëzimin:

- Ngritja e 5 parqeve të mëdha në periferi të Tiranës, pranë Liqeneve malore, duke i bërë ato të vizitueshëm për të apasionuarit e natyrës:
 - Parku i Kollogjeshit, sipërfaqe rreth 2000 ha
 - Parku i Liqenit të Kasharit, rreth 100 ha
 - Parku i Liqenit të Rovës, Baldushk, rreth 200 ha
 - Parku i Liqenit të Fjollës, Pezë, rreth 100 ha
 - Parku i Liqenit të Prushit, Lalm dhe Allgjatë, rreth 30 ha;
 - Parku 3-Liqenor i Linzës, Tufinës dhe Priskës, rreth 20 ha.
- Do të krijojmë “Kurorën e gjelbër të Tiranës” duke pyllëzuar rreth 400 ha me fidanë të llojeve të ndyshëm halorë dhe fletorë, në njësitë administrative Petrelë, Farkë, Kashar, Dajt, Kërrabë, Bezhitë Vaqarr.
- Në ekonomitë pyjore Fag, Kllojke, Verri, Bizë, Rovë Lunxh, Pezë, Shesh, Shkallë, Kostenjë, Parkun Kombëtarë Dajt dhe Zonën e Mbrojtur Brosh Berdhë, do të rehabilitojmë 10.000 ha të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të degraduara nga prerjet, zjarret dhe veprimtaritë e ndryshme ekonomike nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit,
- Do të realizojmë ngritjen e Fidanishtes së Tiranës posaçërisht për rritjen dhe trajtimin e fidanëve për gjelbërimin e qytetit
- Nuk do të preket më asnjë metër nga perimetri ekzistues i Parkut të Madh të Liqenit Artificial. Njëkohësisht do të kryhet inventari total dhe të mbetet në vëmendjen kryesore të Bashkisë duke përmirësuar strukturën e grumbujve pyjorë.
- Mbështetje fermerëve me fidanë pyjor falas dhe dhënia e sipërfaqeve të zhveshura për të mbjellë ato me bimë mjekësore dhe eterovajore, duke i pyllëzuar dhe përdorur për një afat 30 vjeçar



B. Pastrimi i lumenjve, Liqeneve dhe siguria e digave

- **Do të ndërhyhet me rehabilitim të liqeneve artificiale** përreth qytetit duke rritur sigurinë e digave dhe përshtatjen e këtyre sipërfaqeve ujore në atraksion të ri për qytetarët. Kthehen në atraksion për viztorët pikat si: Liqeni i Linzës, Tufinës, Fjollës, Priskës, Rovës etj.
- **Ndertimi i Ligatinave Ekologjike per 130 fshatrat e Tiranës.** Për të gjitha zonat rurale urbane si psh fshatrat, që nuk kanë sistem të kanaleve të ujërave të zeza do të merren masa konkrete si: Ndërtimin e ligatinave ekologjike që sjellin pastrimin e ujëve të zeza, eleminojnë rrjedhjen dhe ndotjen e tokës, pastrimin e ujërave të bardha sipërfaqësore dhe nëntokësore

C. Promovimi i Ekoturizmit dhe Ngritjen dhe financimin e kampeve verore per te rinjtë

- Për të nxitur veprimtarinë ekonomike dhe argëtuese, ruajtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit, do të vendoset një fond prej 2 milionë euro nga buxheti i Bashkisë, që do të përdoren për zhvillimin e infrastrukturës, kreditimit e turizmit (në bashkëpunim me sektorin privat) në pyje dhe kullota si dhe krijimit të lehtësirave fiskale për katër vitet e para të aktivitetit për aktivitetet me qëllim shlodhës, pushimi dhe argëtimi;



- Investimet në shtëpitë model të zonave rurale me qëllim rritjen e kapaciteteve pritëse për ekoturizmin, si dhe trajnimin e guidave turistike
- Për të gjithë blegtorët mbështetje me ndertim infrastrukture rrugore dhe financim për infrastrukture akomoduese ne stane (kontinier, baraka druri) si dhe baxho të përpunimit të qumështit dhe tregje shitje të produkteve me vlerën e tregut. (Duke mbështetur për të rritur prodhimet bio).
- Ngritjen dhe financimin e kampeve verore per te rinjtë ne Bize, Malin me Gropa. M. Dajtit dhe ne Liqenet afer Kryeqytetit
- Do të promovojmë sportin e gjuetisë, duke bërë së pari, vlerësimin e popullatave të kafsheve te egra objekt gjuetie, dhe së dyti, vendosjen e stadardeve per promovimin e nje gjuetie racionale per qellime sportive dhe turistike;





Oaz
I GJELBËR

500 OAZE
TË GJELBRA
PËR TIRANËN







04



Arsimi

Çerdhe e kopshte për çdo familje të Tiranës

Dyfishimi i çerdheve dhe kopshteve

Në vitin e parë të qeverisjes, e gjithë sipërfaqja e ndërtuar që vjen prej taksës 3% si kontribut social i sektorit të ndërtimit, do të përdoret për të ndërtuar çerdhe dhe kopshte të reja.

Me ritmin aktual të ndërtimit, kjo taksë do të mundësojë mjaftueshëm sipërfaqje të ndërtuar për arritur dyfishimin e numrit kopshteve dhe çerdheve të reja në Tiranë.



Kuponi për çerdhe e kopshte

Duke filluar prej vitit të dytë bashkia do të shpërndajë kuponin për çerdhe e kopshte, për të gjitha ato familje që nuk kanë marrë përgjigje pozitive ndaj kërkesës për t'i çuar fëmijët e tyre në çerdhe apo publike. Pra familjet të cilat nuk kanë pasur mundësi që të regjistrojnë fëmijën në çerdhe apo kopësht publik, do të marrin një bonus financiar për të lehtësuar kostot e çarjes së fëmijëve në struktura private.

Ky bonus që do të jepet për të mbuluar pjesërisht faturat e shërbimit privat do të përsëritet çdo vit, derisa kërkesa e familjeve për të regjistruar fëmijën në kopësht apo çerdhe publike të marrë përgjigje pozitive.

Përfitimet

Lehtësimi i Kostos së Jetesës

Rritja e kapaciteteve për të pranuar fëmijë në çerdhe dhe kopshte publike do të thotë që mijëra familje të Tiranës do të kursejnë ndjeshëm në buxhetet sepse nuk do detyrohen të çojnë fëmijët e tyre në çerdhe apo kopshte private. Po ashtu kuponit lehtëson kostot e shërbimit privat për familjet që nuk gjejnë vend për fëmijët e tyre në çerdhe apo kopshte publike.

Po ashtu ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve në zonat ku ende nuk ka, do kursejë paratë e transportit dhe kohën. Ky ndërtim do iu mundësojë familjeve që t'i çojnë fëmijët pranë vendbanimit për arsimit parashkollor e të mos detyrohen të shkojnë për ti shoqëruar në lagje të tjera.

Mbështetje për nënat e reja

Për më tepër arsimit parashkollor lehtëson jetën e nënave të reja të cilat nëse kanë çerdhe apo kopshte ku mund të çojnë fëmijët e tyre vegjël do të kenë më shumë mundësi që të marrin një rol më aktiv në shoqëri dhe ekonomie ndërsa në anën tjetër.

Zhvillim cilësor i fëmijëve

Studimet të shumta kanë vënë në dukje se shkollimi gjatë moshës së hershme 0-6 vjeç, kur edhe zhvillohet rreth 90% e trurit të njeriut, ka një ndikim vendimtar në ndërtimin e aftësive kyçe kognitive, emocionale, sociale dhe fizike të njeriut. Këto përbëjnë edhe asetet themelore për të shkëlqyer në shkollë dhe për të pasur suksesin të mëvonshëm të njeriut në jetë.

Shkolla cilësore e të mjaftueshme kudo e për të gjithë!

Pothuaj gjysma e shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të Tiranës janë me dy turne ose tejet të mbipopulluara. Çdo zonë, çdo njësi do të ketë aq shkolla sa edhe i nevojiten. Zona të tëra ku banojnë dhjetëra mijëra banorë si Astiri, apo zona afër Liqenit të Thatë nuk kanë fare shkolla;

Brenda vitit të parë, të gjitha të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimit, do të shkojnë për të zgjidhur nevojën emergjente për infrastrukturë shkollore. Kjo taksë përlllogaritet nga 4% deri në 8% të vlerës së çdo investimi dhe vetëm për vitin që kaloi ishte 60 milionë euro.

ARSEM



Në tetë vite të qeverisjes së Erjon Veliajt në Tiranë, ai ka marrë nga kjo taksë në total afro 400 milionë euro të cilat do të kishin mjaftuar që të përmbushnin disa herë kërkesën e qytetarëve për shkolla për fëmijët e tyre.

Fondet e një viti do të dedikohen menjëherë për të ndërtuar shkolla të reja atje ku nuk ka, e mandej për të ndërtuar institucione të reja shkollore në ato zona apo lagje të Tiranës që i kanë shkollat ekzistuese publike të mbi-populluara.

Institucionet e arsimit publik parashkollor e para-universitar nuk do të ndërtohen me kostot e tejfryra të qeverisjes lokale të deritanishme, por me kostot e arsyeshme me të cilat i ka ndërtuar Bashkim Evropian apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Pra duke shmangur vjedhjen me këto projekte, do të kursehen fonde për të ndërtuar institucione të reja publike të arsimit pa zhvatur qytetaret e Tiranës.

Përfitimet

Ulet kostoja e jetës

Shkolla pranë vendbanimeve kursen kohën dhe shpenzimet e transportit që harxhohen nga familja për të çuar fëmijët në shkolla larg shtëpisë.

Rrit cilësinë e burimeve njerëzore

Investimi në zgjerimin dhe modernizimin e infrastrukturës shkollore ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e procesit arsimor duke nxjerrë të rinj më të kualifikuar e përgatitur për të qenë më të suksesshëm në tregun e punës.

Heqja e taksës së jashtëzakonshme për arsimin

Që prej muajit shkurt 2016 në faturat tatimore të ujit për abonentët familjare në Tiranë është shtuar “taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore”. Kjo taksë ishte parashikuar të zgjaste 7 vjet mirëpo ende po vazhdon të paguhet. Të ardhurat e grumbulluara prej saj ishin paramenduar të përdreshin për rikonstrukcionin apo ndërtimin e shkollave, kopshteve dhe çerdheve mirëpo kjo gjë nuk ka ndodhur. Janë rreth 41 milionë euro shtesë që janë mbledhur prej kësaj takse që ka rritur koston e jetesës së qytetarëve, pa marrë gjë në këmbim prej saj.

Kjo taksë do të hiqet, dhe investimet për infrastrukturën shkollore do të mbulohen nga burimet e tjera të të ardhurave të bashkisë. Shkollimi publik është një nga detyrimet kryesore bazike që ka një bashki e zakonshme dhe prandaj nuk ka nevojë për taksa të jashtëzakonshme.

Përfitimet

Lehtësohet kostoja e jetesës

Heqja e kësaj takse do të ulë sadopak barrën fiskale të familjeve të Tiranës. Të ardhurat e bashkisë prej taksimit të sektorit të ndërtimit mjaftojnë për ta zgjidhur njëherë e mirë nevojën e qytetarëve për çerdhe, kopshte dhe shkolla publike.

Objektivat e Tjerë për Arsimin:

Programi ynë për Arsimin do të ketë në qendër: cilësinë shërbimit arsimor dhe interesin më të mirë të nxënësve.

Për herë të parë, Bashkia jonë do të angazhohet në CILËSINË e mësimdhënies dhe nxënies në shkollat tona. Përgjegjshmëria, Transaprenca dhe Llogaridhënia publike do të jenë vlerat udhëheqëse të bashkëpunimit me komunitetet prindërore të shkollave tona.

Për Nxënësit

- Do krijohet dhe do përdoret çdo mundësi financiare që eleminon braktisjen (në zonë rurale apo në qytet). Asnjë fëmijë i moshës shkollore nuk do ngelet pa marrë shërbimin arsimor.
- Do të krijohet dhe do të përdoret çdo mundësi financiare për mbështetjen e regjistrimit në shkollat e mesme të Bashkisë sonë të të gjithë nxënësve që mbarojnë arsimin e detyruar në fshat apo qytet.
- Mbështetje financiare, me qëllim motivimin e nxënësve me arritje shkollore shumë të mira nga klasa e 6 e arsimit bazë, deri në klasën e 12 të arsimit të mesëm. Mbulimin e kostove për çdo shkollë që do të organizojë mësimdhënie të vecantë për nxënësit me **arritje të larta shkollore** dhe ato me **nevoja për përmirësim**.
- Mbështetje financiare, me qëllim motivimin e nxënësve me arritje shkollore të larta që dallohen në olimpiada, konkurse etj në nivel Bashke dhe vendi.
- Do të krijohen dhe do financohen programe të posaçme dhe të realizueshme që do të ofrohen nga shkolla për mbështetjen e nxënësve në zhvillimin e talenteve të tyre.
- Mbulimin financiar të aktiviteteve të nxënësve (kulturore, artistike, mjedisore etj) me ndikim në komunitetet tona.
- Program promovues dhe mbështetës për orientimin e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë drejtë arsimit të mesëm profesional dhe krijimin e programeve mbështetëse për punësimin e nxënësve që mbarojnë arsimin profesional.
- Mbështetje financiare për mbulimin e kostove të mjeteve didaktike për realizimin e kurrikulave lëndore.

Për Mësuesit

- Mbështetje\shpërblim financiar për mësuesit e suksesshëm, e shprehur përmes arritjeve shkollore të nxënësve dhe vlerësimeve të prindërve.
- Mbulimin\rimbursimin financiar që mësuesit shpenzojnë për trainimin dhe kualifikimin e tyre, në kuadër të plotësisimit të detyrimit ligjor për zhvillimin e tyre profesional.
- Mbulimin\shpërblimin financiar për mësuesit që realizojnë programet e posacme për mbështetjen e nxënësve në kapërcimin e vështirësive në të nxënë, në përmirësimin dhe konsolidimin e arritjeve shkolle.
- Mbulimin\shpërblimin financiar për mësuesit që realizojnë programet e posacme për mbështetjen e nxënësve të klasave kolektive.
- Mbulimin/shpërblimin financiar për mësuesit që do të asistojnë dhe mbështesin shkollimin dhe integrimin social të nxënësve me Aftësi Ndryshe.
- Mbështetje financiare për mbulimin e kostove të transportit të mësuesesve.



Për Prindërit

- “Paketa e Edukimit”, do të jetë një instrument ndihme dhe mbështetje për familjet në nevojë dhe me mundësi të kufizuara ekonomiko financiare, për shkollimin e fëmijëve të tyre. (Kjo paketë, propozohet për herë të parë dhe konsiston në mbulimin financiar, të përvitshëm të mjeteve didaktike për çdo lëndë që fëmija realizon në shkollë. (cantën, fletoret, fletore pune/ushtrimes, lapsa, stilolapsa, setin e aparatit pedagogjik, uniforma sportive etj).

- Mbulimin financiar të kostove (transportit), për aktivitetet ekstrakurrikulare që planifikon\realizon shkolla.
- Do të inkurajojmë, motivojmë dhe financojmë nxënësit që synojnë dhe provojnë të mësuarin e një Mjeshtrie\Zeje\Zanati në një subjekt të licencuar në Bashkinë tonë.

Infrastruktura Shkollore

- Çdo kopsht dhe shkollë publike, do të ketë mjedise mësimore normale, funksionale, të sigurta, me të gjitha kushtet higjienike, dekorative\estetike.
- Sigurimin dhe mbulimin financiar të kostove të mjeteve didaktike të kopshteve të nevojshme për realizimin e kurrikules zyrtare. Mjediset e ngrënies dhe pushimit të fëmijëve në Kopshte do të jenë në standardet më të mira dhe për çdo nxënës\fëmijë.
- Program të veçantë për fëmijët e braktisur, të neglizhuar apo jashtë përgjegjësisë prindërore, të çdo komuniteti. Ky program do të konsistojë në mëbshtetjen e edukimit të posaçëm dhe deri në integrimin e tyre në sistemin arsimore dhe më tej në tregun e punës.
- Bibliotekat e shkollës, atje ku është e mundur, do të organizohen dhe rivitalizohen duke krijuar salla\mjedise të përshtatëshme për punën e nxënësve dhe mësuesve me librin.
- Oborret e shkollave, në çdo shkollë që është e mundur do të financohet në fuksion të krijimit të një mjedisi miqësor, edukativ, funksional e qytetar të nxënësve.
- “Paketa e Kab/Lab”. Në çdo shkollë, 9-vjecare dhe të mesme, Kabinetet dhe Labororet sipas lëndëve, do të ndërtohen/pajisen sipas standardit teknik dhe pedagogjik. Raporti i mjeteve dhe paisjeve laboratorike do të sugurojë aksesin dhe nxënien për çdo nxënësi.
- Konviktet e institucioneve tona shkollore do të jenë në qendër të investime të Bashkisë. Synimi i rikonstruksioneve dhe godinave të reja do të ketë synimin do të jetë jeta\trajtimi dinjitoz dhe i sigurtë i çdo nxënësi si dhe kthimin e tyre në qendra të vërteta të edukimit.

Bashkia dhe Universiteti


- Bashkia do të ketë bashkëpunim dhe do të ofrojë mbështetje për çdo institucion të arsimit të larë dhe me çdo Njësi Kryesore (fakultet), për përmirësimet infrastrukturore dhe mjediseve të tyre.
- Zgjerimi i kapaciteteve të konvikteve. Ngritja e konvikteve të reja do të jetë pjesë e përvitshme e buxhetit\financimit të Bashkisë;
- Aksesimi i studentëve në institucionet kulturore, sportive, artistike të Bashkisë do të jetë pa pagesë;
- Inkurajimi dhe mbështetja e partneritetit të orperatorëve ekonomik me institucionet e arsimit të lartë.

Bashkëpunim i qëndrueshëm dhe mbështetje e çdo aktiviteti, projekt\programi të organizatave dhe shoqatave studentore





05



PLANIFIKIMI URBAN



Tirana Metropol Policentrik i orientuar drejt qytetarit!

Dy do të jenë qasjet kryesore të tranzitimit të Tiranës nga një tejshtirrije urbano-rurale në dikotomi me densitet të lartë, drejt nje Metropoli Policentrik në harmoni të plotë me njerëzoren.

A- Qasja makro (nga lartë- poshtë):

- Do punojmë për ta kthyer Tiranën në një Metropol Policentrik. Ku çdo komunë që i është bashkuar Tiranës pas reformes Teritoriale 2015 dhe çdo njësi administrative të para kësaj reforme, të kthehet në një pol të ri potencial zhvillimi ekonomik e urban
- Polet e reja të zhvillimit (ish-komunat) do të konsiderohen si “edge city” (qytete satelitore) dhe të kthehen në qytete po aq të rëndësishme sa vetë Tirana qendrore. Kurse polet e reja të zhvillimit në brendësi të Tiranës së sotme (ish-njësitë administrative) do stimulohen të krijojnë individualitetin e vet dhe një ndarje të qartë nga “guacka” e vjetër e Tiranës
- Marrdhenia midis poleve të ndryshme të Tiranës së të ardhmes nuk do jetë, sikurse është marrdhenie hirearkike, por marrdhenie midis entiteteve ekonomiko- urbane të barabarta.
- Këto marrdhënie do të mbështeten në dy karakteristika thelbesore: specializimi dhe komplementariteti. Ekonomia e Tiranës Metropol policentrik nuk do jetë shumatorja e ekonomive të poleve, por shumë me tepër, sepse marrdhenie te tilla krijojnë produkte sinergjike.
- Këto rezultate do të synohen nëpërmjet instrumentit të planifikimit të përgjithshëm territorial të Bashkisë Tiranë (PPV). Rishikimi i tij në këtë synim, do të jetë një prioritet i administratës së ardhshme.



B- Qasja Mikro (poshtë- lartë):

- Do të punojmë për ta kthyer strukturën formuese të secilit prej të gjitha poleve të Tiranës në strukture hirearkike njësisht strukturore urbane, ku thelbi është përshtatja e tyre me dimensionin njerezor.
- Qeliza më e vogël e poleve do të jetë blloku mix i banimit/ ekonomisë së tregtisë dhe shërbimeve. Kjo qelizë duke u bashkuar me të ngjashme, dhe duke përfshirë nevoja apo kërkesa humane (aktivitete njerezore) do të krijojë nivele të tjera të njësisht strukturore urbane (më të mëdha: komplekse dhe lagje), deri në formësimin e strukturës urbano-ekonomike të polit.
- Struktura hirearkike e njësisht do të na lejoj që ta mbështesim lëvizjen: në njësitë strukturore të vogla bazuar te 'energji njerezore'. Kjo: do të minimizojë përdorimin e automjeteve private; do të ndikoj në aksesin më të shpejtë dhe më të pavarur të nevojave dhe kërkesave të banorëve; do të ndikojë në përmirësimin e mjedisit të qytetit; do të impaktojë pozitivisht shëndetin qytetar; etj.
- Këto rezultate do të synohen nëpërmjet instrumenteve të kontrollit të zhvillimit të Bashkisë Tiranë (PDV). Hartimi në masë, dhe rishikimi i një pjese prej tyre në këtë synim, do të jetë një prioritet i administratës së ardhshme.

C- Strehimi (përfshirë strehimin social)

- Asnjë nga pesë programet që parashikon ligji sektorial nuk i shërben synimit që një shoqëri liberale ka ndaj kësaj fushe veprimtarie qeverisëse. Të gjitha programet përjashtojnë të varfërit dhe adresojnë nevojat e shtresës së mesme dhe të pasur. Nga to përfitojnë vetëm kompanitë e preferuara të ndërtimit dhe/ose bankat e nivelit të dytë. Ne do ta ndryshojmë këtë.
- Ndryshe nga administratat e mëparshme, ne do ta trajtojmë strehimin (stokun e banesave të krijuar rishtas) si një funksion të plotë, që përfshin strehimin sipas tregut dhe strehimin social (atë për të cilin kërkohet ndihma e shoqërisë).
- Synimi ynë i parë është sjellja e çështjes së tregut imobiliar në shinat e ekonomisë së tregut të lirë, ku çmimi nuk vendoset nga një grupsh njerëzish të preferuar por nga mekanizmat e tregut të lirë.

- Kjo do të sjelli që në pak vite çmimi të bjeri 30-40 % të çmimit të sotëm (ky nuk është një premtim, por një parashikim me nivel të lartë pasaktësie, referuar kostove dhe një nivel të pranuar fitimi). Përveç të tjerash, kjo do të sjelli siguri në tregun bankar (referuar kredive hipotekore), por edhe për çdo familje që zotëron titullin e pronësisë së banesës së saj).
- Ulja e çmimit të banesave do të zvogëloj gjithashtu hendekun midis banesës dhe familjeve që kanë nevoje për to. Çfarë do të uli numrin e familjeve që do të kenë nevojë për ndihmën e shoqërisë për tu pajisur me një banesë.

D- Propozimi për ndryshim nga qasja ‘strehimi si pjata më e rëndësishme e urbanistikës’.

- Ndryshimi i mënyrës së planifikimit, projektimit dhe administrimit të zhvillimit urban, do ta kthej Bashkinë në një nga pronaret më të mëdhenj të apartamenteve të ndërtuara sipas këtyre projekteve dhe planeve urbane. Kjo do të uli ndjeshëm nevojën e taksimit për qëllim të strehimit social (3%), çfarë do të ndikonte në uljen e mëtejshme të çmimeve në tregun e lirë.
- Ndryshimi i qasjes, në dy mënyrat e prezantuar më sipër - (i) duke e parë strehimin si një të tërë dhe jo vetëm strehimin social, (ii) duke e parë strehimin si produkt të planifikimit /projektimit /menaxhimit urban- do të prodhoj ndarjen (pavarësinë) midis krijimit të stokut bashkiak të banesave dhe shpërndarjes së tyre për familjet që vërtet kanë nevojë.
- Këto do të çlironin buxhetin e bashkisë nga nevoja për të alokuar fonde publike për strehimin social, çfarë nga ana e saj do të krijonte mundësinë e uljes së taksave për qytetarët, apo rialokimin e tyre drejt një politike tjetër publike.

E- Mirëmbajtja dhe modernizimi i stokut ekzistues të banesave.

- Një sasi e konsiderueshme e stoku të banesave në Tiranë janë në ndërtesa të ndërtuara në vitet e socializmit. Një çështje e rëndësishme për strehimin është mirëmbajtja e këtij stoku, i cili po vjeterohet me shpejtësi, për shumë arsye.

- Problematikat me energjinë janë një çështje thelbësore në situatën botërore. Në këtë kontekst, përfshirë në proceset mirëmbajtëse të apartamenteve dhe sipërfaqet e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, do të implementohen projekte për konservimin e energjisë në to.
- Këto projekte do të shërbejnë gjithashtu edhe në drejtim të 'kapaciteteve adaptuese' ndaj ndryshimeve klimatike, duke ditur se Tirana, sikurse gjithë Shqipëria, është një vend me nivel të lartë 'vulnerabiliteti' ndaj tyre.
- Në financimin dhe zbatimin e projekteve të mirëmbajtjes dhe modernizimit në, nga njëra anë do të vendosim standarte teknike orientuese apo të detyruara për tu zbatuar, nga ana tjetër do të inkurajojmë përfshirjen e forcave të tregut të lirë. Kjo do të ulte nevojën për financime publike, dhe do sillte zvogëlimin e barrës fiskale për taksapaguesit.

Zgjidhja jonë për një problematikë që ekziston, duke respektuar të drejtën kushtetuese të pronës.

Ne e konsiderojmë gjendjen fizike, vizuale dhe mjedisore të ndërtesave shumëfamiljare të banimit, një problematikë reale që kërkon vëmendje të veçantë.

Kjo jo vetëm në lidhje dhe të "kujtuar" nga tërmeti – sikurse po na thotë qeveria, që u kujtua pas 30 muajsh të prodhojë legjislacion për këtë temë, por si një qasje të integruar për shkak të:

1. Vjetërimit të tyre moshor, nevojës për rikonstruksione të plota dhe të pjeshme që nuk janë kryer që prej ndërtimit të tyre (pavarësisht se kur janë ndërtuar)


2. Materialeve të dobëta dhe teknikave shumë të prapambetuara nëpërmjet të cilave janë ndërtuar

3. Dikotomisë së gjendjes fizike, vizive dhe mjedisore, midis hapësirave private (apartamenteve) që kanë pësuar përmirësime nga pronari, dhe hapësirave të bashkëpronësisë që janë trajtuar si të askujt

4. Nevojës për adaptim në lidhje me ngrohjen globale (efiçencën e energjisë në banesa) dhe teknologjitë e reja.


Qasja jonë e integruar nuk kufizohet vetëm te ndërtesa shumëfamiljare e banimit si një entitet më vete, por te gjithë njësia strukturore urbane ku ajo bën pjesë. (Tirana Metropol Policentrik i Fokusuar te Njeriu) Ne do ta trajtojmë këtë problematikë të rëndë urbane si pjesë e projektimit, administrimit dhe zhvillimit (rizhvillimit) të njësisë strukturore urbane (për më shumë do të flasim urbanistët dhe arkitektët e ekipit). Të fokusuar te vlerësimi i gjendjes së ndërtesave, ne do të ndjekim një projekt mbështetur në metodën e “Skanimit të Përzier”, sipas së cilës:

1. Do të bëhet një auditim primar për të gjitha ndërtesat në qytet (jo të kornizuar brenda bashkësisë së ndërtesave që janë më shumë se 50-vjeçare)



2. Në varësi të përfundimeve nga auditimi primar, do të kryhet auditimi i thelluar për ato ndërtesa që nuk e kanë kaluar auditimin fillestar. Ndërtesat që do të tregojnë rrezikshmëri edhe pas auditimit të thelluar do t'i nënshtrohen prishjes dhe do të rindërtohen me financim publik në të njëjtin vend dhe në të njëjtët parametra volumorë sikurse ishin përpara prishjes.

Së bashku me rikonstrukcionin e plotë të godinave që nuk tregojnë rrezik për jetën, por që kanë nevojë për t'iu nënshtuar ndërhyrjeve për përmirësim të qëndrueshmërisë mekanike apo për përmirësim e rinovim funksional viziv e mjedisor (përfshirë eficensën e energjisë), ato do të trajtohen si një unitet i vetëm urban (njësinë strukturore urbane që i përfshin).





06

 **TI TIRANA**



Inteligjenca Artificiale po e ndryshon botën në mënyrë të paimagjinueshme dhe shumë shpejt duke ofruar mudësi të reja për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Për të ndjekur hapin e kohës, pjesë e vizionit të ndryshimit ka për të qenë Tirana Inteligjente, do ta vendosë teknologjinë në shërbim të modernizimit të mjedisit urban, duke u përqendruar tek kërkesat e qytetarëve dhe nevojat e tyre të përditshme .

Tirana Inteligjente është një koncept urbanizimi i cili përdor teknologjinë dhe të dhënat për të për të rritur efikasitetin e qeverisjes së bashkisë, për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe për të minimizuar ndikimin e qytetit në mjedis.

Tiranë është një qytet i madh dhe me shpejtësi rritjeje, i cili mund të përfitojë nga ky koncept për të përmirësuar shërbimet publike, rritur efikasitetin e qeverisjes dhe të zvogëluar koston e këtyre shërbimeve. Me përdorimin e teknologjisë dhe të dhënave, Tiranë mund të bëhet një qytet më i inteligjent dhe me zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e saj.

Si pjesë e kësaj platforme, trafiku do të menaxhohet më lehtë. Çdonjëri do mund ta ndjekë autobusin lehtësisht nga celulari, për të parë se ku gjendet dhe kur mbërrin në stacion. Çdo stacion do të ketë të dhënat e nevojshme dhe pika karikimi. Udhëzuesit për përdorimin e linjave, si dhe informacionet turistike do të jenë të gjitha në dorën tuaj, në një vend.

Për një shofer, nëpërmjet TI do të mundësojë që të dallohen parkingjet e lira dhe të prenotohen paraprakisht. Ata që kanë në zotërim parkime private, do të mund t'i japin në përdorim sa herë që i kanë të lira dhe të përfitojnë nga kjo. Ata që kanë makina elektrike, do kenë më shumë pika karikimi anembanë qytetit për të inkurajuar këtë mënyrë ekologjike të transportit.

Semaforët inteligjentë do të vihen në punë që t'i përshtaten mbingarkesës, duke e shfryrë trafikun. Koshat e mbeturinave përmes sensorëve gjithashtu do të ndihmojnë për të pasur një mjedis më të pastër.

Me Tiranën Inteligjente, Interneti do të jetë falas në të gjitha hapësirat publike dhe vende të caktuara do kenë informacione shitesë si për turistët, ashtu dhe për banorët.

Nëpërmjet kësaj platforme Bashkia ta ndërthurë teknologjinë maksimalisht me mjedisin urban, që çdo qytetar të ketë në dorën e tij qytetin. Paralelisht do të ulen taksat për të gjithë komunitetin e teknologjisë, për të nxitur sa më shumë të rinjtë të qendrojnë dhe punojnë në Tiranë.

Piramida, do të jetë 100% në dorë të komunitetit të teknologjisë. Do gjenden të gjitha mundësitë që Piramida të jetë realisht një qendër inovacioni dhe jo një qendër tregtare, siç ka në plan ta bëjë Erion Veliaj për miqtë e tij.

Përfitimet janë të shumëfishta:

- Sipas studimeve, zbatimi i inteligjencës artificiale si ky i TI, ul 80% nivelin e korrupsionit në administratë, për shkak të automatizimit të sistemit, duke e bërë cdo shërbim plotësisht transparent dhe efikas.
- Me qëllim gjenerimin e një konsensusi sa më të madh për projektet e bashkisë, kjo shton edhe demokracinë dixhitale sepse platforma do të përdoret për të përfshirë në vendim- marrje e konsultime qytetarët nëpërmjet peticioneve apo referendumeve elektronike.
- Platformat dixhitale dhe aplikacionet mund të ndihmojnë qytetarët të kenë një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbime publike
- Përdorimi i teknologjisë dhe të dhënave mund të ndihmojë në përmirësimin e trafikut dhe në zvogëlimin e kohës së udhëtimit. Kjo do të reduktojë edhe ndotjen e ajrit dhe ndikimin në mjedis.
- Kjo platformë gjithashtu mund të ndihmojë në të ardhmen në përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesa dhe infrastrukturë publike, duke ndikuar në zvogëlimin e koston energjetik dhe në ndikimin në mjedis.





07



SHËRBIMI SOCIAL

SHËRBIMI SOCIAL DHE VENDIMMARRJA QYTETARE

SHËRBIMET SOCIALE, KONSULTIMI I QYTETARËVE DHE SHËRBIMI PËR PUNËSIMIN

- Aksesit në shërbimet sociale të Bashkisë do të jetë i garantuar për të gjithë ata që plotësojnë kriteret
- Organizimi i Referendumeve Qytetare, për të gjitha çështjet e rëndësishme që i takojnë vendimmarrjes në Tiranë
- Deri në fund të katërvjecarit të parë, do të kemi ndërtuar rreth 1200 apartamente të reja sociale dhe dy Shtëpi për të Moshuar, me kapacitet 250 persona. *(Një apartament social ka një sipërfaqe maksimale rreth 70 metër katror. 1200 apartamente janë rreth 84000 metra katro me një kosto ndërtimi mesatare 400 euro/m² (standarti mesatar pa kosto tëke) kushton rreth 33.6 milionë euro)*
- Bonus për blerje apartamentesh nga çiftet e reja me moshë deri në 35 vjeç për mashkullin dhe 30 vjeç për femrën, duke ju dhënë deri në 5 mijë euro për blerjen e një apartamenti të ri nëse do e blejnë atë brenda 1 viti nga data e martesës. *(Parashikohet që të jenë deri në 500 cifte në vit, të moshësh së re që blejnë apartamente që vitin e parë të martesës)*
- Bonus bebe deri në 3 mijë lekë në muaj për të gjithë të bebet deri në moshën 2 vjeç. *(Kushton 4.4 milionë euro, ose 2.2 milionë euro nëse vendoset të jepet vetëm për 1 vit).*
- Programe të posaçme për të moshuarit, vajzat dhe gratë.



A. Programi i Strehimit Social dhe shërbimeve të tjera sociale në Bashkinë Tiranë

Strehimi për kategoritë vulnerabël

Nevoja për strehim social është në rritje jo vetëm për kategoritë e pafavorizuara por edhe për shtresat e mesme të shoqërisë.

Shumë prej familjeve, individëve nuk arrijnë të sigurojnë një strehë të sigurt dhe të përshtatëshme jo vetëm si shkak i pamjaftueshmërisë së të ardhurave, por edhe si shkak i tregut të lartë të cmimit që kanë banesat.

Bashkia e Tiranës trajton të pastrehët bazuar në Ligjin “Për Strehimin Social”, nr. 22/2018 dhe sipas këtij ligji, programet e strehimit social janë:

- 1 Programi i banesave sociale me qira
- 2 Subvencionimi i qirasë
- 3 Banesat me kosto të ulët
- 4 Programi i banesave të specializuara
- 5 Programi i Subvencionimit të Interesave të kredisë
- 6 Programi i strehimit të përkohshëm

- Programi i banesave sociale me qira, sipas të dhënave që kemi, është joaktiv për faktin se nuk ka asnjë banesë të lirë në fondin e këtij programi.
- Banesat me kosto të ulët është një program që nuk aplikohet nga Bashkia e Tiranës dhe nuk asnjë të dhënë se kur mund të fillojë zbatimi i këtij programi. Përfituesit nga ky program mund të jenë gratë kryefamiljare.

- Programi i banesave të specializuara është gjithashtu një program joaktiv i strehimit social dhe nuk ka asnjë informacion nëse Bashkia e Tiranës planifikon të fillojë me aplikimin e këtij programi. Gratë, viktimat të dhunës në familje si dhe viktimat e trafikimit mund të jenë përfituese nga ky program.
- Programi i strehimit të përkohshëm është gjithashtu një program që nuk është aktiv dhe nuk ka asnjë të dhënë për të.

Bashkia Tiranë shprehet se për periudhën kohore 2018-2020 janë regjistruar në zyrat e saj 6708 qytetarë aplikantë të programeve sociale të strehimit, prej të cilëve 1829 janë shpallur fitues. Por, programet që ofron Bashkia Tiranë dhe që janë aktive, janë vetëm dy:

- Subvencionimi i qirasë
- Programi i Subvencionimit të interesave të kredisë

Subvencionimi i qirasë është një nga programet, që asiston më shumë gratë kryefamiljare dhe viktimat të dhunës në familje sepse: a) mbulon deri në 100% pagesën e qirasë dhe b) është programi që garanton zgjidhje më të shpejta në kohë në krahasim me programet e tjera.

Programi i Subvencionimit të interesave të kredive është një program që paraqet problematika të shumta për aplikuesit e tij. Ky program ka disa kufizime. Kufizimi më i rëndësishëm është niveli i të ardhurave i kërkuar nga kriteret e aplikimit si dhe kriteret për miratimin e kredisë. Niveli i të ardhurave i kërkuar nga ky program pengon një numër të madh grash kryefamiljare për të qënë përfituese nga ky program, për shkak se ato janë nën nivelin e të ardhurave mesatare.

Por Bashkia nuk ka bazë të të dhënave për aplikimet në programet e strehimit social. Gjithsesi, shifrat e mëposhtme janë marrë nga studime të ndryshme të pavarura. Të dhënat janë për vitet 2019 dhe 2020 për dy programet aktive të strehimit social dhe janë paraqitur aplikimet e e përgjithshme në total, aplikimet e grave kryefamiljare dhe viktimat të dhunës në familje si dhe numri i përfituesve për këto kategori.

Viti	Programi	Aplikime (burra dhe gra)	Aplikime Gra, kryefamiljare dhe gra të dhunës në familje	Përfituese Gra Kryefamiljare	Përfituese Gra, viktime të shunës në familje
2019	Subvencionimi i qirasë	1028	130	52	5
	Subvencionimi i interesave të kredisë	-	-	-	-
2020	Subvencionimi i qirasë	663	100	58	2
	Subvencionimi i interesave të kredisë	2250	-	93	2

Buxheti i Bashkisë së Tiranës për Strehimin Social për vitin 2021 mbulon vetëm Bonusin e Strehimit në vlerën 80.000.000 Lekë dhe ka parashikime të vecanta për të pastrehët që do të rezultojnë nga 2 projekte të zhvillimit të qytetit .

Bashkia Tiranë do të harxhojë vetëm rreth 74.7 mln lekë për suvencionimin e kredive të buta.

Bashkia parashikon të bëjë investime per ndertimin e banesave sociale referuar kontributit te sektorit privat nga 2.88 mld që është fondi kompleksiv, parashikohen të investohen 1.68 mld në 2023 dhe nga 600 mln lekë në 2024 dhe 2025. Zgjidhjet e propozuara janë:

- Bonus për blerje apartamentesh nga çiftet e reja;
- Bonus bebe për të stimuluar lindjet në Bashkinë Tiranë dhe mbajten e të rinjve në vend
- Vlëra prej 3%, e destinuar per sherbimin social te strehimit, do te arketohet ne nje llogari te veçante te Bashkisë, me destinacion vetem Programin Social te Strehimit. Financat e akumuluar nuk do te mund te perdoren per asnje desrtinacion tjeter, sic ka ndodhur deri me sot me BT
- Në bazë të të dhënave, vetëm nga taksa e mësipërme për shërbimin social, duhet të jenë mbledhur rreth 110 milionë euro të ardhura vetëm në tre vitet e fundit, të cilat në se shpenzohen pikërisht për destinacionin e tyre, japin një zgjidhje të qëndrueshme problemit të strehimit social

- Programi i strehimit social do të zgjerohet dhe do të inkludojë edhe të rinjtë dhe çiftet e reja dhe ato me fëmijë të vegjel, të cilët e kanë të pamundur fillimin e jetës së tyre për shkak të të ardhurave të ulta që kanë

Kapacitet e Bashkisë së Tiranës

Bashkia e Tiranës ka kapacitete të pamjaftueshme manaxheriale dhe financiare (sipas studimeve, minimalisht 5 herë më të ulët se kërkesa/ nevoja e qytetarëve për strehim social), gjë e cila sjell përjashtim dhe mohim të së drejtës për strehim të sigurt dhe përshtatshëm për shumë qytetarë të tyre.

Mohimi apo pamundësia për të patur një strehë të sigurt dhe të përshtatshme sjell automatikisht problematika të tjera sociale dhe ekonomike të cilat ndikojnë në edukimin/funksionimin por shpesh

herë edhe në zhvillimin e brezave të ardhshëm dhe për pasojë të gjithë shoqërisë;

Qytetarët e Tiranës kanë mungesë informacioni për shërbimet që ofrojnë strukturat shtetërore në lidhje me strehimin social

Bashkia e Tiranës nuk bën transparente asetet që ata kanë në menaxhim, apo përqindje të hapsirave, apartamenteve që duhet të përdoren për strehim social nga çdo leje e re për ndërtim që ata japin. Si konkluzion mund të themi:

- Bashkia e Tiranës nuk kujdeset për të bërë shërbimet e qarta, transparente dhe të njohura për targetin që shënjestrojnë
- Numri i aplikantëve për përfshirje në programet sociale të strehimit nuk tregon në fakt nevojën reale për strehim, pasi shumë prej qytetarëve kanë humbur shpresën dhe besimin te institucionet për zgjidhjen e çështjes dhe as nuk aplikojnë më
- Mungon totalisht vëmendja e strukturave të Bashkisë së Tiranës për ta bërë të matshëm problemin e strehimit (nuk ka studime të mirëfillta dhe të kohë pas kohëshme)
- Bashkia e Tiranës nuk realizon analiza me qëllim identifikimin e nevojës për strehim si dhe identifikimin e burimeve lokale të cilat mund të mobilizohen me qëllim plotësimin e nevojave

- Do të hartohen programe afatgjatë strehimi dhe shetbimesh sociale, duke i bërë bërë transparente, të kuptueshme dhe të arritshme ato për grupet përfituese. Në planifikimin strategjik do të konsultohen të gjitha grupet e interesit
- Shuma e vendosur deri tani nga ana e Bashkisë është plotësisht e pamjaftueshme për të përballuar një Tiranë në rritje të përhershme të popullatës dhe për rrjedhojë të shërbimeve sociale që popullata ka nevojë
- Transparenca për të dhënat kryesore në lidhje me shërbimet sociale të Bashkisë do të jetë e plotë dhe e aksesueshme nga të tjerë.
- Për të gjitha shqetësimet që kanë lidhje me problemat e shtresave vulnerabël, të moshuarit në pamundësi për të lëvizuar, dhunën në familje, parkimin, pastrimin, ujësjellës kanalizimet, ankimimin për Policinë Bashkiake, do të vendoset një linjë telefonike pa pagesë, (psh 311, si NY) ku do të regjistrohen dhe do të jepet zgjidhje problemeve të qytetarëve.

B. Konsultimi me Qytetarët si thelbi i vendimarrjes së Bashkisë

Shqetësim në Tiranë është veçanërisht vendim-marrja dhe transparenca përkatëse.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor, kryesisht në kohë krizash merr një rëndësi të dorës së parë. E drejta për informimim, konsultimi publik, mbledhjet e hapura, strukturat komunitare, iniciativa qytetare, e drejta e kërkesës ankeses dhe verejtjes, referendumet popullore janë instrumenta që parashikon ligji për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga bashkitë. Në realitet qytetarët nuk janë pjesë e vendimarrjes lokale. Ata nuk marrin mbledhjet e këshillit bashkiak të Tiranës, madje këto mbledhje në katër vitet e fundit mbahen totalisht jashtë vëmendjes së qytetarëve.

Mungojnë iniciativa që detyrojnë të zgjedhurit e tyre të konsiderojnë prioritetet që ata kanë në komunitet etj. Nismat janë sporadike kryesisht nga shoqata dhe OJF lokale të cilat nuk kanë arritur të krijojnë një impakt të qëndrueshëm në ndergjegjesimin e qytetarëve për rëndësinë që ka pjesëmarrja e tyre në përmirësimin e jetës së tyre të përbashkët.

Për këtë arsye:

- Organizimi referendumeve për çështje që kërkojnë shprehjen nominative të qytareve
- Diskutimi me qytetaret në nivel vendor i punëve dhe investimeve të bashkise në mënyrë prioritetizuar. Procesi i diskutimit do të organizohet nga bashkia
- Diskutimi me qytetaret i buxhetit të bashkise dhe se si janë të përfshira prioritetet që ata kanë vendosur në një proces diskutimi paraprak
- Diskutimi i nivelit të taksave dhe tarifave vendore
- Informimi i qytetareve sistematik dhe integruar të shërbimeve sociale që mundësohet ligjërisht nga qeverisja qendrore dhe ajo lokale. Cilat janë grupet përfituese
- Krijimi i një platforme të përbashkët komunitare e cila do të menaxhojë situatat në rast katastrofash natyrore

C. Programi i posaçëm për të moshuarit

Strehimi për të Moshuarit

Një komponent shumë i rëndësishëm në strehimin social është edhe strehimi për të moshuarit e vetmuar. Aktualisht në Tiranë ka vetëm një shtëpi për të moshuarit çka është shumë pak. Aksesit në shërbimet e tij është thuajse i pamundur.

Nuk ka të dhëna të bazuara sesa është kërkesa/aplikimi për këtë kategori, por ndërtimi i strukturave të tjera është një domosdoshmëri për Tiranën. Pensioni mesatar urban është 17.258 lekë/muaj dhe ai rural është 9.656 lekë/muaj.

Mjafton të përmendet që në rastet kur i janë referuar mediat, një person që i ka plotësuar kriteret për tu strehuar në këtë shtëpi pleqsh i është dashur një periudhë pritje prej 2.5 vitesh, që në kushtet e të moshuarve është një periudhë shumë e gjatë.

- Deri në fund të katërvjeçarit të parë, do të kemi ndërtuar rreth 1200 apartamente të reja sociale dhe dy shtëpi për të moshuarit, me kapacitet 250 persona.





Shërbimi ambulant në shtëpi

Të moshuarit preferojnë të qëndrojnë në komunitetet e tyre ku janë mësuar e kanë kaluar një pjesë të mirë të jetës. Në vend që të kalojnë në një komunitet të ri, qoftë edhe në një komunitet që mund të jetë më i përshtatshëm fizikisht për nevojat e tyre, shumica dërrmuese e të moshuarve preferojnë të qëndrojnë aty ku janë.

Ndryshimi i nevojave për kujdesin shëndetësor, humbja e lëvizshmërisë, shqetësimet financiare, mirëmbajtja e shtëpisë, megjithatë, paraqesin pengesa të rëndësishme për këtë dëshirë të thjeshtë dhe parësore.

“Moshë e tretë në shtëpi” është një gamë e larmishme programesh nga bashkia që do të adresojnë këto pengesa, duke kërkuar të mbajnë të moshuarit si anëtarë integralë dhe produktivë të komuniteteve të tyre si dhe që të rrisin dinjitetin personal dhe pavarësinë funksionale të të rriturve të moshuar.

Një ndër mënyrat për ta realizuar është ndërtimi i katër Qendrave të Shërbimit në Banesë. Ky shërbim ambulant do të jepet për persona të moshuar ose me aftësi të kufizuara, të cilët nuk janë në gjendje të

kujdesen për veten dhe që nuk mund të ndihmohen nga pjesëtarë të familjes ose një kujdestar.

Qendrat Ditore për të Moshuar

Bashkia e Tiranës ka përgjegjësi që të kujdeset e të garantojë mirëqenien e të gjithë qytetarëve, përfshi edhe të moshuarit të cilët gjithnjë e më shumë përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të popullisë.

Prandaj për të konsoliduar mbështetjen për moshën e tretë pranë vendbanimit të tyre, Bashkia e Tiranës do të ndërtojë 6 qendra të reja ditore për të moshuarit të cilat do të synojnë përmirësimin e jetesës së të moshuarve dhe reduktimin e izolimit social të tyre duke ofruar shërbime sociale, mbështetje shëndetësore dhe ushqimore.

Qendrat Ditore të të Moshuarve do të ndërtohen në bazë të praktikave më të mira e duke përfutur edhe nga përvoja e pasur e Kryqit të Kuq në Shqipëri që operon një sërë qendrash të tilla.

Secila prej tyre do të ketë si qëllim dhënien e shërbimeve sociale për të moshuarit e vetmuar dhe me probleme sociale pranë vendbanimit të tyre. Ato do të ofrojnë falas për banorët e moshuar të zonës shërbim psiko-social, shërbim shëndetësor, vakte ushqimore, aktivitete zbavitëse.

Këto dy nismat e fundit nuk iu shërbejnë vetëm të moshuarve, por edhe lehtëson gratë nga detyrimi familjar përkundrejt të moshuarve duke iu dhënë atyre më shumë mundësi e liri për të pasur angazhim ekonomik apo social.

C. Programi i posaçëm për vajzat dhe gratë

PËR VAJZAT DHE GRATË E TIRANËS

Vizioni i ndryshimit bazohet tek premisa që qeverisja e bashkisë në të ardhmen të dëgjojë dhe adresojë të gjitha shqetësimet e qytetarëve tanë. Në veçanti, vajzat dhe gratë e Tiranës përballen me sfida dhe vështirësi të mëdha. Arritja e barazisë gjinore dhe forcimi i rolit të vajzave dhe gruas janë një parakusht për një shoqëri të zhvilluar dhe prandaj përbëjnë një pjesë të rëndësishme të vizionit tonë për për ndryshimin e qeverisjes së Tiranës. Ky ndryshim është në duart e qytetarëve dhe më poshtë janë 10 propozime që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës për vajzat dhe gratë.

1. Fuqizimi ekonomik

- Në krye të këtyre përpjekjeve ka për të qenë synimi i fuqizimit ekonomik të grave në Tiranë prandaj bashkia do të hartojë politika të veçanta për të siguruar lehtësira tatimore për bizneset private që punësojnë gra si dhe për ato biznese që themelohen e udhëhiqen nga gratë.
- Mbështetje për gratë biznesmene duke ulur ndjeshëm barrën fiskale dhe duke ndërtuar një klimë sa më të përshtatshme biznesore në Tiranë.
- Në grantet apo subvencionet e dhëna nga qeveria lokale përparësi të madhe do të kenë aplikantët që i përkasin gjinisë femërore.

2. Mbështetja e nënave që kujdesen për fëmijët

- Arsimi parashkollor ndikon në jetën e nënave të reja të cilat nëse kanë çerdhe apo kopshte ku mund të çojnë fëmijët e tyre vegjël do të kenë më shumë mundësi që të marrin një rol më aktiv në shoqëri dhe ekonomi. Prandaj do të bëhet dyfishimi i çerdheve dhe kopshteve të Tiranës duke përdorur të gjithë sipërfaqjen që vjen prej taksës 3% si kontribut social i sektorit të ndërtimit për këtë objektiv
- Kuponi për çerdhe e kopshte do të jepet për familjet të cilat nuk kanë pasur mundësi që të regjistrojnë fëmijën në çerdhe apo kopësht publik në mënyrë që të lehtësojnë kostot e çuarjes së fëmijëve në struktura private.
- Brenda vitit të parë, të gjitha të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimit, do të shkojnë për të zgjidhur nevojën emergjente për infrastrukturë shkollore në mënyrë që mos të ketë më shkolla me turne.
- Programi “Pas shkolle” është një tërësi veprimtarish mësimore të cilat ju vijnë në ndihmë fëmijëve përtej orarit të mësimit që të konsolidojnë përgatitjen mësimore dhe të zhvillojnë aftësi apo përvetësojnë njohuri të reja.

3. Lehtësimi i grave nga detyrimi familjar përkundrejt të moshuarve

- Një tjetër detyrim që kanë gratë në familje është kujdesi për të moshuarit në familje prandaj bashkia do të ndërtojë qendra të reja ditore për të moshuarit të cilat do të synojnë përmirësimin e jetesës së të moshuarve dhe reduktimin e izolimit të tyre duke ofruar shërbime sociale,

- Bashkia do të krijojë shërbimin ambulant do të jepet për persona të moshuar të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten.

4. Rritja e Sigurisë

- Përmirësimi i ndriçimit në hapësirat publike
- Instalimi i kamerave të sigurisë në ambiente publike dhe në të gjithë autobusët publik
- Rritja e pranisë së policisë bashkiake në zonat me shkallë të lartë rrezikshmërie
- Vendosje e telefonave të emergjencës nëpër stacione autobusi

5. Nxitja e shkollimit të vajzave

- Arsimimi është një ndër mënyrat më efikase për të përmirësuar statusin social të grave në shoqëri prandaj do të angazhohet që të ndihmojë sa të mundet në mbulimin e shpenzimeve të shkollës për familjet në nevojë
- Do të hartojë programe të posaçme të bursave për të ndihmuar familjet që t'i dërgojnë vajzat e tyre të talentuara në universite apo trajnime brenda e jashtë vendit.
- Bashkia do të mbështesë gara të posaçme për vajza të cilat do të kenë për qëllim nxjerrjen në pah të talenteve.



6. Vëmendje e shtuar për vajzat dhe gratë në rrezik

- Duke aplikuar politikën e tolerancës zero kundrejt dhunës ndaj tyre do të ndërtohet një linjë e këshillimit si shërbim i veçantë i bashkisë për vajzat dhe gratë në rrezik apo që janë ballafaquar me dhunë.
- Do të investohet në krijimin e një infrastrukture efikase lokale që jep shërbime të përgjithshme dhe të specializuara për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave e dhunë në familje.
- Re-integrim i grave dhe vajzave viktime të dhunës nëpërmjet ofrimit të banesave sociale, punësimit, formimit profesional dhe ndihmës e shërbimeve sociale.

7. Më shumë rol për vajzat e gratë në bashki

- Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave jo vetëm në poste periferike por në poste të larta të vendim-marrjes në bashkinë e Tiranës.
- Për të thyer stereotipet do të të rrisim prezencën e grave në profesione të konsideruara si jo tradicionale për to, si policia bashkiake, inspektoriate etj.
- Programi i internshipit pranë institucioneve bashkiake do të favorizojë vajzat e reja.

8. Përmirësimi i Transportit Publik

- Autobusi falas do të ketë ndikim të veçantë tek vajzat e gratë të cilat e përdorin më shumë transportin publik.
- Bashkia do të investojë në modernizimin e shërbimit të transportit public falas duke zgjeruar rrjetin dhe bërë të mundur që autobusët të jenë më efikas, cilësorë, të sigurtë dhe të përpiktë.
- Linjat do të ofrohet 24 orë për të mundësuar transportin publik të grave që kanë nevojë të udhëtojnë natën

9. Emancipimi shoqëror

- Për të ndryshuar statusin e grave në shoqëri shumë e nevojshme është që të ndryshohet gjithashtu edhe mentaliteti shoqëror dhe t'iu jepet fund sjelljeve stereotipike paragjyquese si dhe modeleve që nxisin veprime të dhunshme e diskriminuese.

Për këtë qëllim bashkia e Tiranës do të ndërmarrë fushata sensibilizuese për promovimin e barazisë gjinore në shkollat e Tiranës dhe në mbarë opinionin publik.

10. Programi i Artizanatit

- Një projekt që është përdorur me sukses në shumë vende për të siguruar burime të adhurash shtesë për të gra shtëpiake është Programi i Artizanatit. Ideja është që të angazhohen gra të zonave periferike dhe rurale të Tiranës për të punuar nga shtëpia në produkte artizanati siç janë trikotazhi, tekstil, filigran, punë dore ne përgjithësi.

Bashkia do të përgatis një plan të veçantë për të identifikuar gratë e familjeve në nevojë, trajnuar dhe mundësuar pajisjet e duhura dhe ndërtimi të një dyqani të specializuar që të merret me shitjen dhe promovimin e prodhimeve të tyre të dorës.





08



UJËSJELLËSI

Çfarë mund të bëhet për të rregulluar sektorin dhe UK Tiranë/zgjidhje

Për fatin tonë të mirë ne kemi modele suksesi: Rasti Pogradec dhe Korçë të cilat operojnë me tarifa të përbalueshme nga popullata për të treja shërbimet së bashku: ujë i pijshëm, kanalizime dhe trajtim i ujërave të ndotura.

- Ideimi dhe vënia në funksion i një sistemi të mirëmenduar që parashikon popullatën, dendësinë e saj të ndryshme në zona të ndryshme brenda dhe jashtë pjesës urbane dhe nevoja e skemave alternative për pjesën rurale të bashkisë. Planifikimi urban dhe plani i të gjitha shërbimeve përfshirë këtu ujin e pijshëm të cilat ecin në të njëjtin drejtim është parakusht për ngritjen e një rrjeti të ri të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve sanitare.
- Investime në rrjet të cilat i qëndrojnë kohës – pra të mos ketë nevojë që të riparohen tubacionet e shpërndarjes. Investime cilësore!!!!
- Një sistem tarifimi i drejtë. Pra paguaj atë që merr. Rasti i dy bashkive të suksesshme të KFW ka qenë koordinimi i investimeve me rritjen graduale të tarifave dhe ndjekja hap pas hapi e grumbullimit të tyre.



— Kur u realizua në Pogradec, në Tiranë potenciali i përballeshmërisë së popullatës është më i lartë prandaj nuk ka asnjë arsye që shërbimi i ujit dhe kanalizimeve të realizohet.

- Aktualisht në zonat informale furnizim me ujë është i pamënaxhueshëm, ç` ka përbën edhe rritjen e konsiderueshme të humbjeve
- Për këtë nevojitet ndërtimi i rrjeteve të mirëfillta të furnizimit me ujë dhe sidomos pajisja e çdo banese apo biznesi me matësa
- Investime në sistemin e matjes në prodhim dhe në shpërndarje që raportimi i humbjeve të jetë i kontrollueshëm për këdo
- Investime në rrjet kryesor ku ka ndërhyrje të paautorizuara. Eleminimi i humbjeve

Të gjitha këto do të bëjnë që ne të kemi orare më të zgjatura të furnizimit me ujë nëpër shtëpitë tona dhe me një kosto më të ulët.





09

**TRASHËGIMIA
KULTURORE
DHE
HISTORIKE**

Arti dhe Kultura jo vetëm si llogjikë sektoriale por pjesë integrale e planifikimit urban të qytetit

Pra kur planifikohet zhvillimi i një zone të caktuar të Tiranës, krahas hapësirave të gjelbëra duhet analizuar gjendja dhe nevoja e komunitetit për art dhe kulturë bazuar në numrin e banorëve, target grupet sociale, etj

P.sh. në njësinë 2 që ka gati 80 mijë banorë, nevojitet një kinema autor, një multisallë, teatër lagjeje, etj. Pra duhen studime empirike për gjendjen, indikatorët, nevojat e komuniteteve për art kulturë.

- Koncepti i decentralizimit. Çdo njësi bashkiake të ketë fondin e vet për kulturën, të pavarur prej bashkisë qendrore.

A. Situata shumë problematike sot

Tirana gjendet sot në një situatë të paprecedentë përsa i përket rrënimin të trashëgimisë kulturore, arkitektonike dhe historike të saj.

Në vitet e qeverisjes socialiste të Bashkisë së Tiranës, nën presionin e madh të industrisë së ndërtimit dhe flukseve të mëdha të parave që vijnë nga aktivitete ekonomike informale dhe kriminale, është goditur kujtesa kulturore dhe historike e Kryeqytetit.


Bashkia në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës në vitin 2018 zvogëluan zonën qendrore të Tiranës, e shpallur Ansabel Historik. Kjo zonë u cungua me VKM për ti hapur rrugën kullave në qendër.

Qendra historike e qytetit të Tiranës është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistike arkitekturore që dokumenton zhvillimin historik të qytetit të Tiranës dhe arritjet në arkitekturën dhe ne urbanistikë.

Jashtë qendrës historike u lanë:

- ✓ Muzeu historik Kombëtar
- ✓ Zona rreth Pallatit të Kulturës
- ✓ Parqet e gropës së Hajdin Sejdisë
- ✓ Parqet para Parlamentit
- ✓ Vila e bllokut nga Lana deri te Universiteti i Arteve
- ✓ Zona e Gardës

- ✓ Parku mbrapa Korpusit qendror të Universitetit
- ✓ Zona rreth Sheratonit
- ✓ Fusha pas Kryeministrisë
- ✓ Vilat nga Piramida deri te Stadiumi
- ✓ Zona e gjelbër përgjatë Lanës deri te Rruga e Elbasanit



- Janë nxjerrë jashtë kategorisë “Monument Kulture” edhe 36 vila/ndërtesa historike
- U shemb Teatri Kombëtar
- Aktualisht, Tirana ka humbur 17 godina monumente historike të kryeqytetit, të cilat janë zëvendësuar me pallate dhe një numër i madh i tyre janë drejt degradimit total, në pritje për t’u kthyer në kantiere ndërtimi

Mbrojtja e vilave historike që kanë status monument kulture, nga presioni i industrisë së ndërtimit. Ne do të mbështesim me instrumente financiare pronarët e këtyre Vilave, nëpërmjet kompesimit të drejtë, kompensim i drejtë sipas tregut.

Për këtë do të kërkohet edhe bashkëfinancimi nga qeveria qendrore. Më pas këto vila mund të rivitalizohen, në bashkëpunim me operatorë privat, për ti kthyer në vende të artit, kulturës dhe aktiviteteve sociale edukative, turistike ekonomike etj, duke respektuar kriteret e veçantë të përdorimit.

Mund të shihet mundësia që disa vila të kthehen në muze të komuniteteve që qytetarët të jenë kontribues pro-aktive, duke kuruar, mbledhur dhe ekspozuar kujtime foto shkrime objekte etj pranë këtyre shtëpive -muze. Kjo shërben për të mbajtur gjallë lidhjen me territorin.

Tezat/Propozimet/Zgjidhjet

1. Rishikim përfundimtar i Planit të Përgjithshëm Vendor TR030

Plani i përgjithshëm vendor TR030 bazohet në idenë e ruajtjes së godinave historike pasi kjo është e domosdoshme për të kuptuar historinë e Shqipërisë dhe Tiranës, pasi kjo e fundit të mund të kthehet në një muze në qiell të hapur i gjeopolitikës së Shekullit të XX", - shkruhet në raportin përmbledhës TR030.

Rishikimi i Planit Vendor të Tiranës do të mundësojë:

- **a.** kthim në identitet të qytetit të Tiranës, rishikim i njollës së godinave historike
- **b.** një metropol modern i adaptuar për nevojat e banorëve të tij
- **c.** krijimi i hartës së qendrave multifunksionale periferike

2. Rikthimi i ansamblit historik në qendër të kryeqytetit

Të rikthehet zona e mbrojtur e qendrës historike të Tiranës si para vendimit të vitit 2018.

3. Krijimi i inspektoriatit të trashëgimisë kulturore, si strukture permanente e Bashkisë Tiranë, me kompetenca të qarta dhe përcaktuese në mbrotje të trashëgimisë kulturore dhe historike të Tiranës. Njëkohësisht, rishikimi i gjithë legjislacionit për ndërtesat e vjetra, monumentet e objektet monument kulture në Tiranë, me kompetenca të forta të qarta.

4. Rindërtimi i Teatrit Kombëtar siç ishte, aty ku ishte!

5. Identifikimi dhe shpallja e ish -objekteve industriale të Tiranës me vlerë arkitektonike të veçantë me një status të veçantë, që konsiston në rikthim në objekte të vizitueshme, qendra social kulturore. Për ndërtesat në pronësi të bashkisë ! Ska nevojë për TUMO në mes të Tiranës, po hapësira të vjetra ku piktorët apo skulptorët ti marrin në përdorim, me qëllim ta shndërrojnë në qendër komunitare për kurse për komunitetin.

6. Qendra multifunkionale Tiranës i mungojnë salla teatroshe apo salla multifunkionale, kemi vetëm Qendrën Ten dhe Teatrin e Metropolit. Tirana ka nevojë për më shumë hapësira për kulturë.

Krijimi i hartës së qendrave multifunkionale periferike që të rinjtë mos të shfrytëzojnë vetëm bllokun si vend argëtimi por ti japin jetë dhe kuptim aty ku jetojnë. Kjo shërben dhe për gjallërimin ekonomik të këtyre territoreve.

Mund të planifikohen kate të para ndërtesash, në qendër dhe periferi dhe Bashkia të mbështesë pagesën e qirave 50% me çmim referencë. Zona Kinostudio, Kombinat, Laprakë, Oxhaku etj, për ti dhënë jetë periferisë.



Hapësirat publike të konsiderohen si hapësira prodhimi dhe ekspozimi duke gjallëruar artin e rrugës.

Kjo formë e të bërit art krijon kohezion qytetar, dhe u jep një simbolikë hapësirave, që kështu të kthehen në skena të hapura artistike jo vetëm rrugë apo hapësira kalimi. Ish-Blloku psh, në një orë të natës, apo sheshi Nënë Tereza.

Kjo kërkon programe mbështetje për artin e rrugës, cirkun e Tiranës veçanërisht.

7. Rigjallërimi i prodhimit artizanal vendor në funksion të turizim. Mbështetje me grante. Aktualisht këtë viti mbështetja nga Ministria e Kulturës për zejtarinë është 100 mil të vjetra, skandaloze. Mbështetja duhet të 10- fishohet në harkun kohor të 4 viteve.

8. Programme mbështetëse për të rinj që financojnë projekte në Industrinë krijuese (design urban, IT, teknologji, modë, arkitekturë urbane , etj. Ndhmë të rinjve me bursa studimi specializimi në kryeqytetet Europiane.

9. Promovimi i turizmit të fundjavave në Tiranë. Tirana nuk njihet nga të huajt për turizimin e fundjavave për aktivitete apo evente të veçanta. Psh muzika Jazz, moda, ekspozita etj. Duhet shfrytëzuar më shumë turizmi fqinj, por kjo bëhet duke ndërtuar një strategji promovimi kulturor të Tiranës. Evente, ngjarje, rituale që e bëjnë Tiranën tërheqëse për nga produkti kulturor që ofron.







10

SPORTI

Ta bëjmë sportin një mënyrë jetese!

- 2% e buxhetit të qeverisjes vendore nga Bashkia e Tiranës do të shkojnë në dobi të sportit
- Ndërtimi i 4 poleve sportive shumësportëshe në kryeqytet
- Ndërtimi i 3 palestrave - salla sportive për lojërat me dorë në standardet olimpike

Bashkia e Tiranës **do të investojë edhe në 4 pole të reja sportive:**

1

Poli Sportiv Lindor, do të vendoset në sipërfaqen nga zona e Freskut deri te Liqeni i Farkës

2

Poli Sportiv Verior, do të vendoset në zonën nga Paskuqani deri te zgjatimi i Bulevardit të Ri

3

Poli Sportiv Perëndimor, do të vendoset në zonën nga Pallati i Sportit deri në Kashar

4

Poli Sportiv Jugor, do të vendoset në zonën mbi Kodrën e Diellit dhe Kopshtin Botanik

- Në të katër polet do të ndërtohen facilitete rekreativo-sportive për shumë disiplina sportive, të cilat do t'u mundësohen qytetarëve pa pagesë në çdo orë të ditës
- **Në Tiranë, brenda mandatit të parë, do të ndërtohen edhe 3 palestra** (salla sportive për lojërat me dorë) të reja, moderne dhe të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, me qëllim rritjen e mundësive stërvitore të sportistëve elitare.
- **Ndërtimin e 50 pikave të hapura brenda qytetit** të Tiranës, me vegla sportive dhe minifushë basketbolli



BELIND KËLLIÇI



www.belindkellci.al

 /belindkellci

 /@belind.kellci

 /BelindKellci.Official